# DËSHMI ARKIVI

**A-440100**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Protesta para Kryeministrisë në ditën e 106-të, Ilir Xhemalaj: Edi Rama të largohet dhe t'i hapë rrugë qeverisë teknike |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/protesta-para-kryeministrise-ne-diten-e-106-te-ilir-xhemalaj-edi-rama-te-largohet-dhe-ti-hape-rruge-qeverise-teknike/1009612/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 16:38:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 16:34:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a834b3947be0aa9a8fb2460ab3e23d4c31a412698f9a53375c005587e6483f59` |
| TEKSTI | `26a68fe04dd98c84d12785da3bf1a5ffa43bdc3e1cee5d7322324b78bf826d0c` |
| PAMJA | `70a0324d60853f8d88ff3c01e5319ca633fe9ff4ce872949cb5b9d6645b9e78b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1c3d956df6a3015b93aa9689541324193e8948cf2fc68a590060f17bf3a6fd2c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a605a4f1977ffafcd955a727087f4d8630a9c3b096f49d9eff2d57be1cc228b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1c3d956df6a3015b93aa9689541324193e8948cf2fc68a590060f17bf3a6fd2c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Protesta para Kryeministrisë në ditën e 106-të, Ilir Xhemalaj: Edi Rama të largohet dhe t'i hapë rrugë qeverisë teknike



Protesta e zhvilluar para Kryeministrisë ka hyrë në ditën e 106-të, ndërsa aktivisti Ilir Xhemalaj deklaroi në studion e News24 se aksioni qytetar do të vijojë deri në dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama dhe krijimin e kushteve për një qeveri teknike.

"Uroj që kjo protestë të përfundojë që nesër, Rama të japë dorëheqjen dhe secili prej nesh të rikthehet te shqetësimet dhe problemet e veta në shtëpi. Por duket se ai do ta vështirësojë një gjë të tillë. Megjithatë, besoj se do t'ia dalim patjetër", tha Xhemalaj në nisje të intervistës.

Aktivisti u ndal edhe te angazhimi i diasporës shqiptare në Britaninë e Madhe, Gjermani, Itali dhe vende të tjera të Evropës. Sipas tij, diaspora ka udhëhequr protestën për pesë ditë radhazi, duke e çuar reagimin në një fazë të mosbindjes civile.

"Diaspora është qendra e protestës, sepse ajo e motivon dhe e mbështet këtë qëndresë. Prania e saj ka ndikim të madh te qytetarët që ndodhen në Shqipëri. Kur emigrantët vijnë e protestojnë pasi kanë përshkuar një rrugë të gjatë, qytetari nga Tirana, Fieri apo Elbasani mendon: 'Nëse ata po vijnë nga diaspora dhe po protestojnë, pse të mos shkoj edhe unë?'", u shpreh ai.

Xhemalaj denoncoi gjithashtu largimin e madh të të rinjve nga vendi dhe zëvendësimin e punëtorëve shqiptarë me fuqi punëtore të huaj. "Problemi kryesor për të cilin po flasim është shpopullimi i Shqipërisë. Kjo duket si një proces i qëllimshëm, që synon largimin e shqiptarëve dhe sjelljen e popullsive të tjera. Ne jemi një komb shumë i vogël për të përballuar një fluks kaq të madh emigracioni", deklaroi aktivisti.

Duke shpjeguar motivet e protestës, ai tha se kundërshtimi nuk lidhet vetëm me ligje të veçanta, por me atë që e cilësoi si kapje të shtetit në tërësi.

të fundit/


OVL-UÇK: Ndërkombëtarët të mos ndërhyjnë politikisht n…


Pas fitores ndaj Vllaznisë, Qatip Osmani: Ishte e…


Trump i kërkon Zelenskyt të ndalë sulmet ndaj naftës ru…


Barcelona fiton në transfertë ndaj Levantes dhe rikthe h…


Prishtina synon serinë e pestë të fitoreve, Feronikeli '74 kërkon…


Drita kërkon rikthimin te fitorja, Gjilani synon të ruajë ritmin: Dalin…


Gjini: Qeveria "Kurti 4" është jokushtetuese, Aleanca do t'i drejtoh…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

"Kemi ligjin për zonat e mbrojtura, shitjen e tokave bujqësore të huajve, paketën e maleve dhe KAYO-n, që përbën një vjedhje të hapur të taksave të shqiptarëve. Të gjitha këto ligje kanë një pikë të përbashkët: Edi Ramën. Për këtë arsye, pa u larguar Edi Rama, këto ligje nuk mund të zhbëhen. Ai duhet të ikë, të krijohet një qeveri teknike dhe të realizohet reforma zgjedhore", theksoi Xhemalaj.

Në përfundim të deklaratës së tij, aktivisti kërkoi nga institucionet e drejtësisë që të ndërmarrin hapa ndaj personave përgjegjës për korrupsionin që, sipas tij, ka marrë përmasa të mëdha në vend.

"Çdo ditë kemi një grup të rinjsh që proteston para SPAK-ut dhe kërkon zgjerimin e hetimeve. Në fund, paratë e korrupsionit janë fonde të hequra nga spitalet, pensionet dhe skemat e ndihmës sociale. Janë para që na janë marrë neve", përfundoi Ilir Xhemalaj.

Shtuar më 13.09.2026 18:34

Tags: -Politikë , kryesorë , Lajmet e fundit , Shqiperia , Të Gjitha



Samsung kërkon rrëzimin e padisë pas betejës ligjore me Dua Lipën/ Këngëtarj…



Shpërthimi me tritol në Shkodër, autori u paraqit si shpërndarës picash dhe …



Zjarr në një banesë në Fushë-Krujë, shembet çatia nga flakët



"Dilni jashtë"/ Egla Ceno rrëfen debatin me Ramën në Berat: U irritua dhe…



Pacolli padit Shqipërinë në Arbitrazh: Aeroporti i Vlorës po merret për t'iu dhënë…



Rama hap 4 Universitete, Shkodra mbetet jashtë/ Boçi: Hakmarrje politike



"PISA 2025"/ BIRN: Pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me…



FOTOT/ Alessio Aliaj zhvendoset në Tiranë, nis bashkëjetesën me Jonida…

albeu
© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.